

Sindikata e të punësuarve në administratë,  
në organet e jurisprudencës dhe në shoqatat e qytetarëve  
të RM-së

**RREGULLORE**  
Për ndarjen e ndihmës në para nga Fondi solidar  
i Sindikatës së AOJSH



Mars, 2016



Në bazë të nenit 28, paragrafi (v) nga Statuti i Sindikatës së AOJSH të RM-së dhe Vendimit për formimin e Fondit solidar, Kryesia e Sindikatës së AOJSH të RM-së, në mbledhjen e mbajtur më datë 03.03.2016 e miratoi tekstin e

## **RREGULLORES**

### **Për ndarjen e ndihmës në para nga Fondi solidar i Sindikatës së AOJSH të RM-së**

#### **I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

Me këtë Rregullore rregullohen, mënyra e ndarjes së mjeteve, shfrytëzuesve, bazat për shfrytëzimin e të drejtave, bazat për shfrytëzimin e mjeteve nga Fondi, procedura për realizimin e të drejtave dhe të tjera nga Fondi solidar i Sindikatës së AOJSH të RM-së (në tekstin e mëtutjeshëm: Fond).

#### **II. BURIME TË MJETEVE**

##### **Neni 2**

Fondi formohet nga këto burime:

- nga një pjesë e pagesës së anëtarësisë sindikale të anëtarëve të Sindikatës së AOJSH, në lartësi prej 0,40% nga shuma e përgjithshme e anëtarësisë nga rroga neto;

- sponzorizime dhe donacione;
- shtesa plotësuese dhe dhurata nga subjekte juridike e fizike, dhe
- burime tjera.

### **Neni 3**

Mjetet në bazë të Nenit 2 nga kjo Rregullore paguhen në xhirollogarinë e veçantë të Fondit solidar të Sindikatës së AOJSH 200000043542128 (numri tatimor) 4030994215699 – deponent Stopanska Banka - Shkup).

Pagesat e mjeteve organizatat sindikale i kryejnë njëkohësisht me pagesat e anëtarësisë sindikale.

### **Neni 4**

Mjetet nga Fondi të cilat nuk do të shfrytëzohen gjatë vitit rrjedhës, do të barten në Fond në vitin e ardhshëm.

## **III. SHFRYTËZUES TË FONDIT**

### **Neni 5**

Shfrytëzues të mjeteve të Fondit janë të gjithë anëtarët e Sindikatës së AOJSH, të cilët paguajnë mjete në bazë të Vendimit për financim.

## IV. BAZAT PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE NGA FONDI

### Neni 6

1. E drejta për shfrytëzimin e mjeteve fitohet pas gjashtë muaj anëtarësim, gjegjësisht pagesë të anëtarësisë dhe atë sipas bazave në vijim:

- ndihmë me para për pushim mjekësor që zgjat më shumë;
- ndihmë me para për shërim;
- ndihmë me para për barna dhe pajisje ndihmëse mjekësore;
- ndihmë me para në rast të gjendjes së keqe materiale të anëtarit të Fondit;
- ndihmë me para për fëmijën e porsalindur;
- ndihmë me para për nxënës të regjistruar në klasë të parë të shkollës fillore;
- ndihmë me para për pasoja më të rënda nga fatkeqësi natyrore;
- ndihmë me para në rast të vdekjes së anëtarit të Fondit;

2) vdekjes së anëtarit të familjes së ngushtë të anëtarit të fondit;

- ndihmë me para për shkuarje në pension;
- ndihmë me para në rast greve;
- ndihmë me para në rast të përjashtimit ose pasojave financiare të shkaktuara për shkak të aktiviteteve sindikale;
- huamarrje në para.

E drejta për shfrytëzim të mjeteve të pakthyeshme nga Fondi sipas bazave të lartpërmendura mund të realizohet vetëm një herë në vit (i njëhershëm) në çfarëdo baze, përveç në raste kur bëhet fjalë për kërkesë për ndihmë me para për fëmijë të porsalindur, ndihmë me para për nxënës të klasës së parë të shkollë fillore, ndihmë me para për shkuarje në pension, ndihmë me para në rast të vdekjes së anëtarit të Sindikatës ose anëtarit të familjes së ngushtë të tij dhe ndihmë me para për fatkeqësi natyrore.

3) Përveç huas, ndihma në para nga të gjitha bazat është e pakthyeshme.

## **1. Ndhimë me para për pushim mjekësor që zgjat më shumë**

### **Neni 7**

1) Ndhimë me para në bazë të pushimit mjekësor të pandërprerë, përveç pushimit të lindjes, fitohet në rastet në vijim:

- kur anëtari ka qenë në pushim mjekësor pandërprerë më shumë se 41 ditë kalendarik.

2) Ndhimë me para në bazë të pushimit mjekësor të pandërprerë ndahet varësisht nga gjatësia e pushimit mjekësor dhe atë:

- nga 41 - 120 ditë..... .. prej 1% - 100%

3) Baza për llogaritje caktohet në shumë prej 10.000,00 denarë.

4) Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni përkatës mjekësor, në afat brenda 30 ditëve pas mbylljes së pushimit mjekësor.

## 2. Ndhimë me para për shërim

### Neni 8

#### a) Shërim në Maqedoni

Në rast të sëmundjes më të rëndë, anëtari i Sindikatës ka të drejtë për ndihmë me para nëse vuan nga sëmundja malinje, cerebrovaskular insult me pasoja të rënda, politrauma, sklerozë multipleks dhe faza terminale të sëmundjes.

Kërkuesi sëmundjen e vërteton me dokumente oficiale, në të cilat edhe sëmundja edhe gjendja e pacientit është përshkruar në mënyrë të padyshimtë. Dokumente mjekësore oficiale janë: mendimi i konsiliumit, fletë-lëshimi, raporti i specialistit me konstatim histopatologjik.

Anëtari i Sindikatës ka të drejtë për ndihmë të njëherëshme me para më së shumti deri në 500 euro në kundërvlerë në denarë.

Kërkesa për ndihmë me para me këtë bazë dorëzohet në afat brenda 30 ditëve.

#### b) Shërim jashtë vendit

Në rast të sëmundjes më të rëndë për të cilën është e nevojshme shërimi jashtë shtetit, anëtari i Sindikatës ka të drejtë për ndihmë me para vetëm në rast kur ajo është miratuar me Aktvendim të lëshuar nga Fondi shëndetësor. Të drejtë për ndihmë me para ka anëtari vetëm për një pjesë të shpenzimeve

të veta, gjegjësisht kur me aktvendim të Fondit shëndetësor nuk është paraparë të mbulohen shpenzimet për shoqëruesin, ndërsa anëtari do të shoqërohet nga anëtari i familjes së ngushtë. Anëtari i Sindikatës mund të fitojë:

- deri 10 ditë qëndrim jashtë shtetit deri 300 euro në kundërvlerë në denarë;
- prej 10 deri 20 ditë qëndrim jashtë shtetit deri 600 euro në kundërvlerë në denarë; dhe
- mbi 20 ditë qëndrim jashtë shtetit deri 1.000 euro në kundërvlerë në denarë.

Kërkuesi është i obliguar të dorëzojë Aktvendim nga Fondi për sigurim shëndetësor për shërim jashtë shtetit, llogari për shpenzimet e përgjithshme gjatë kohës së qëndrimit të cilat nuk janë mbuluar me aktvendimin e Fondit, të cilat do të mbështeten me llogari origjinale për shpenzimet e bëra për vendosje dhe/ose për ushqimin.

Kërkesa për ndihmë në para sipas kësaj baze dorëzohet në afat brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së Aktvendimit nga Fondi për sigurim shëndetësor.

### **3. Ndihmë me para për barna dhe pajisje ndihmëse mjekësore**

#### **Neni 9**

Në rast të sëmundjes më të rëndë (sëmundje malinje, cerebrovaskular insult me pasoja të rënda, politrauma, sklerozë multipleks dhe faza terminale të sëmundjes), për të cilën është e nevojshme furnizim të barnave të cilat nuk janë në listën pozitive



të Fondit për sigurim shëndetësor ose pajisje ndihmëse mjekësore të cilat nuk janë në ngarkesë të fondit për sigurim shëndetësor, ndërsa të njëjtat nuk kanë ndërrim përkatës në listën e fondit, anëtari i Sindikatës ka të drejtë për ndihmë me para prej 20% nga shuma e shpenzimeve që i paguan kërkuesi, por më së shumti deri 500 euro në kundërvlerë në denarë gjatë një viti kalendarik.

Nëse anëtarit të Sindikatës i është caktuar terapia ose i është rekomanduar pajisje ndihmëse mjekësore, të cilat gjenden në listat pozitive të Fondit për sigurim shëndetësor, ndërsa anëtari sipas zgjedhjes dhe bindjes së vetë merr terapi/pajisje ndihmëse mjekësore të cilat nuk janë në listën pozitive të Fondit për sigurim shëndetësor, nuk i takon ndihmë me para.

Ndihmë me para sipas kësaj baze anëtari mundë të fitojë nëse shuma minimale e shpenzimeve të bëra është 10.000,00 denarë. Kërkuesi dorëzon dokumentacion mjekësor me të cilat provon se barnat/pajisjet ndihmëse mjekësore të caktuara /propozuara është e nevojshme t'i përdorë, e të njëjtat nuk janë në listën e FSSH dhe nuk kanë zëvendësim për të njëjtët. Kërkuesi dorëzon faturë/llogari fiskale nga vendi ose jashtë shtetit (të përkthyer) si provë për furnizim.

4) Kërkesa për ndihmë në para sipas kësaj baze dorëzohet në afat brenda 6 muajve nga dita e pranimit të Aktvendimit nga Fondi për sigurim shëndetësor.

#### 4. Ndhimë me para në rast të gjendjes materiale të rrezikuar

##### Neni 10

1) Në rast të rrezikimit të gjendjes materiale në familje, anëtari i Sindikatës ka të drejtë për ndihmë me para. Me rrezikim të gjendjes materiale në familje, në pajtim me nenin paraprak, nënkuptohet gjendja materiale e familjes, në të cilën të ardhurat e përgjithshme në të gjitha bazat nuk janë më shumë se 70% nga rroga neto mesatare në Republikën e Maqedonisë.

2) Lartësia e ndihmës me para sipas kësaj baze është 10.000,00 denarë edhe atë për:

Një anëtar.....	40% nga shuma
Dy anëtarë.....	60% nga shuma
Tre anëtarë.....	80% nga shuma
Katër e më shumë anëtarë.....	100% nga shuma

3) Anëtari ka të drejtë në ndihmë me para sipas kësaj baze në çdo dy vite.

#### 5. Ndhimë me para për fëmijën e porsalindur

##### Neni 11

Anëtarët e Sindikatës përkatësisht prindërit e fëmijës së porsalindur kanë të drejtë në ndihmë me para në shumë prej 3.000,00 denarë për secilin fëmijë të porsalindur.

2) E drejta për ndihmë sipas kësaj baze realizohet më së voni në afat prej 10 muaj (300 ditë) nga dita e lindjes së fëmijës.

## **6. Ndhimë me para për nxënës të regjistruar në klasë të parë të shkollë fillore**

### **Neni 12**

1) Anëtarët e Sindikatës së AOJSH kanë të drejtë në ndihmë me para në shumë prej 3.000,00 denarë për secilin fëmijë të regjistruar në klasë të parë. Të drejtë për këtë kompensim me para kanë anëtarët e Sindikatës së AOJSH, përkatësisht prindërit të cilët i kanë regjistruar fëmijët në klasë të parë.

2) E drejta për ndihmë sipas kësaj baze realizohet në afat prej 60 ditë duke e llogaritur nga dita e parë e fillimit në shkollë.

## **7. Ndhimë me para për pasoja më të rënda nga fatkeqësi natyrore**

### **Neni 13**

1) Në rast kur anëtarit të Sindikatës i janë shkaktuar pasoja më të rënda nga fatkeqësia natyrore në objektin ku jeton, përkatësisht që është në pronësi të tij ose është në pronësi të bashkëshortit/es (vërshim, tërmet, zjarr dhe të ngjashme), ka të drejtë për ndihmë me para në lartësi prej 10% nga dëmi i vlerësuar nga organi kompetent, por jo më shumë se 30.000,00 denarë.

2) Ndhimja në para paguhet në bazë të dokumentacionit përkatës-provës për pronësi, vendit ku jeton dhe vërtetimit për dëmin e shkaktuar të lëshuar nga organi përkatës.

3) E drejta për ndihmë për fatkeqësitë natyrore realizohet në afat brenda 90 ditëve nga dita kur ka ndodhë fatkeqësia natyrore.

## **8. Ndhimë me para në rast të vdekjes së anëtarit të Fondit ose anëtarit të familjes së ngushtë të tij**

### **Neni 14**

1) Në rast të vdekjes së anëtarit të Fondit, familja e të ndjerit ka të drejtë në ndihmë të njehershme me para në shumë prej 20.000,00 denarë.

2) Në rast të vdekjes së anëtarit të familjes së ngushtë të tij, anëtari i Fondit ka të drejtë në ndihmë të njehershme me para në shumë prej 10.000,00 denarë.

3) Kërkesa për ndihmë me para sipas kësaj baze dorëzohet në afat brenda 60 ditëve nga dita e vdekjes.

### **Neni 15**

Anëtarë të familjes së ngushtë në kuptim të nenit paraprag llogariten bashkëshortët dhe fëmijët nëse nuk kanë formuar familje të tyre dhe jetojnë në të njëjtën bashkësi familjare me prindërit, si dhe fëmijët të cilët pas lidhjes së kurorës janë shkukurëzuar dhe përsëri jetojnë në bashkësinë e njëjtë me prindërit.

## **9. Ndhimë me para gjatë grevës**

### **Neni 16**

1) Në rast të grevës së organizuar me vendim të Sindikatës së AOJSH dhe në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune, anëtarët e Sindikatës kanë të drejtë në ndihmë me para. Lartësinë e ndihmës me para e cakton Kryesia e AOJSH.

E drejta për ndihmë nga paragrafi paraprak realizohet vetëm në rast se ditët e kaluara në grevë nuk zëvendësohen në mënyrë plotësuese ose nuk paguhen nga punëdhënësi.

3) Këtë të drejtë mund ta shfrytëzojnë vetëm anëtarët e Sindikatës pjesëmarrës në grevë, në bazë të evidencës së organizatave sindikale.

## **10. Ndihmë me para për shkuarje në pension**

### **Neni 17**

1) Anëtarët e Sindikatës së AOJSH kanë të drejtë për ndihmë në para në shumë prej 3.000,00 denarë për shkuarje në pension.

2) Të drejtë për ndihmë me para sipas kësaj baze kanë anëtarët të cilët në vazhdimësi janë anëtarë në Sindikatë më së paku pesë vite para se të realizojnë të drejtën për shkuarje në pension.

3) E drejta sipas kësaj baze realizohet në afat brenda 60 ditëve nga pranimi i Aktvendimit për pensionim nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Maqedonisë.

## **11. Ndihmë me para në raste përjashtimi ose pasojave financiare të shkaktuara për shkak të aktiviteteve sindikale**

### **Neni 18**

1) Në rast se anëtari i sindikatës së AOJSH përjashtohet nga punëdhënësi për shkak të kundërshtimit të urdhrave lidhur me aktivitetet zgjedhore në Sindikatën e AOJSH ose kryerjen

e aktiviteteve sindikale për mbrojtjen e sindikatës së AOJSH dhe të drejtat e anëtarëve të saj, anëtari i Sindikatës ka të drejtë në ndihmë mujore me para në shumë të neto rrogës të cilën e ka marrë tre muajt e fundit para se të merr aktvendimin për përjashtim. Këtë të drejtë anëtari do ta realizoj deri në plot-fuqishmërinë e procedurës gjyqësore eventuale për kthim në vendin e punës. Mjetet të cilat anëtari do t'i fitoj me procedurë gjyqësore, është i obliguar ti kthej në Fondin solidar më së voni brenda 30 ditëve pas marrjes së tyre.

2) Nëse për shkak të aktiviteteve të theksuara në paragrafin 1 të këtij neni, anëtari i sindikatës dënohet në shumë të përqindjes së të ardhurave të tij mujore, ka të drejtë në kompensim me para në lartësi të shumës deri në përfundim të afatit kohor për të cilin është dënuar.

3) Nëse anëtari i Sindikatës suspendohet nga institucioni në të cilën punon për shkak të aktiviteteve të theksuara në paragrafin 1 të këtij neni, ka të drejtë në kompensim me para në lartësi të rrogës së mbetur, e cila nuk i paguhet, deri në përfundim të suspendimit dhe të procedurës disiplinore.

4) Komisioni i Fondit solidar i Sindikatës së AOJSH në rastet e theksuara në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, do ta thirr anëtarin e Sindikatës dhe Kryetarin e Organizatës sindikale që para Komisionit t'i prezantoj provat për bazueshmërinë e marrjes së ndihmës me para nga Fondi solidar në pajtim me këtë nen.

5) Kërkesa për ndihmë me para me këtë bazë dorëzohet në afat brenda 30 ditëve nga pranimi i Aktvendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës ose Aktvendimit për shqiptim

të masës disiplinorë me dënim me para në shumë një mujore të rogës së anëtarit.

## 12. Hua me para

### Neni 19

Anëtari i sindikatës ka të drejtë huamarrje me para pa interes.

Huaja do të jepet në këto raste edhe atë sipas renditjes prioritare në vijim:

- për shërim (dokumentet e nevojshme: vërtetim nga enti në të cilin shërohet dhe diagnozën për sëmundjen nga e cila shërohet);

- për shkollim (dokumentet e nevojshme: semestër i vërtetuar për vitin vijues dhe shumën e shkollimit);

- për fatkeqësi elementare (dokumentet e nevojshme: vërtetim për pronësi (fletë- pronësi) dhe vërtetim për dëmin e shkaktuar të lëshuar nga organi përkatës) dhe

- për raste të tjera për të cilat Komisioni do të vlerësoj se kërkesa është e arsyeshme.

2) Shuma e huas mund të jetë prej 12.000,00 deri 30.000,00 denarë, ndërsa lartësinë e huas e cakton Komisioni në bazë të dokumenteve të parashtruara.

3) Kthimi i parave është në periudhë prej 12 deri më 20 muaj. Huamarrësi është i obliguar që pas vërtetimit të ndalesës administrative të punëdhënësi si dhe marrëveshjes për shfrytëzim të huas, të paguaj 200,00 denarë shpenzime manipulative në llogarinë e Fondit solidar (200000043542128).

4) Kryetarët e organizatave sindikale janë të obliguar të kontrollojnë kthimin e huas gjegjësisht huaja a paguhet rregullisht. Nëse anëtari nuk e kthen rregullisht huan ose shërbimi për punë kontabiliteti për çfarëdo arsye nuk e kryen pagesën rregullisht, e njëjta do të arkëtohet nga llogaria e Organizatës sindikale. Nëse kryetari i Organizatës sindikale nuk nënshkruan deklaratë për pëlqim, organizata sindikale nuk do të ketë të drejtë të shfrytëzoj mjetet e Fondit solidar të sindikatës.

5) Nëse në një Organizatë sindikale njëkohësisht hua në para kërkojnë më shumë anëtarë, atëherë Kryetari i Organizatës Sindikale është i obliguar të përgatis listë prioriteti të cilën e dorëzon bashkë me kërkesat.

6) Anëtari mund të konkurroj përsëri për hua me para pas 12 muajve nga data e pagesës përfundimtare të huas paraprake.

7) Kërkesat të cilat nuk i plotësojnë kushtet, do të vihen në listën e pritjes deri në kompletimin e tyre.

## Neni 20

Anëtarët e Sindikatës së AOJSH shfrytëzues të mjeteve të kthyeshme dhe të pakthyeshme nga Fondi solidar si dhe pjesëmarrës në aktivitete sportive, arsimore, kulturore dhe aktivitete tjera të organizuara nga Sindikata ose organizatat sindikale, nuk mund të largohen nga anëtarësia në Sindikatën e AOJSH para se të kalojnë dy vite nga pranimi i ndihmës së pakthyeshme në para ose dy vite nga data e pagesës përfundimtare të huas me para (në pajtim me Statutin e Sindikatës së AOJSH, neni 19) si dhe pjesëmarrje në lojëra sportive, arsimore, kulturore dhe ak-



tivitete tjera të organizuara nga Sindikata e AOJSH ose Organizata sindikale.

### **Neni 21**

Nga mjetet e Fondit solidar mund të jepen shpërblime individëve ose organizatave për rezultate posaçërisht të rëndësishme. Kandidatët e propozuar për shpërblime duhet të jenë aktiv dhe anëtarë të provuar të Sindikatës së AOJSH.

### **Neni 22**

Shpërblimi u jepet në formë të plaketës si dhe kompensim me para në shumë maksimale prej 15.000,00 denarë. Kriteret dhe vendimet për dhënien e shpërblimeve dhe lëvdatave i sjell Këshilli ekzekutiv i Sindikatës së AOJSH.

### **Neni 23**

Lëvdatat u jepen anëtarëve të Sindikatës së AOJSH, të cilët janë aktiv dhe janë dalluar në punën e Sindikatës, si dhe organizatave që kanë kontribuar për zhvillimin dhe realizimin e qëllimeve të Sindikatës së AOJSH.

### **Neni 24**

1) Nga Fondi solidar sigurohen mjete për furnizim me rekuizite, shpërblime për pjesëmarrësit si dhe për shpenzime tjera të nevojshme për organizimin e lojërave dhe ndeshjeve sportive të Sindikatës së AOJSH.

2) Nga Fondi solidar sigurohen mjete edhe për pjesëmarrje në lojërat sportive ndërkombëtare. Për numrin e pjesëmarrësve dhe shumën e mjeteve, vendim sjell Këshilli ekzekutiv.

### **Neni 25**

Nga Fondi solidar mund të kompensohen shpenzimet për mbajtjen e këshillimeve, seminareve, protestave, edukimit të kuadrit sindikal, mirëmbajtjen dhe përsosjen e WEB faqes dhe programeve për punë, të cilat do të jenë në funksion për kryerjen në kohë dhe në mënyrë kualitative të funksioneve të Sindikatës dhe informimin e anëtarëve.

### **Neni 26**

Nga Fondi solidar kompensohen edhe:

- anëtarësia vjetore për Organizatën sindikale botërore të sindikatave të shërbimeve publike (PSI) dhe Federatën Evropiane të sindikatave të shërbimeve publike (EPSU, dhe
- hua në llogari për punën rrjedhëse të Sindikatës së AOJSH në rast nevojë.

## **V. PROCEDURA PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE**

### **Neni 27**

1) Kërkesën për shfrytëzimin e ndonjë të drejte, në pajtim me këtë Rregullore anëtarët e Sindikatës, ia parashetrojnë Kryetarit të Organizatës sindikale, kurse në organizatat sindikale ku ka të besueshëm, të besuarit, i cili pastaj kërkesën ia dorëzon Kryetarit të Organizatës sindikale.

2) Kryetari i Organizatës sindikale kërkesën ia dorëzon Komisionit për shpërndarjen e mjeteve të Fondit solidar në Sindikatën e AOJSH. Me kërkesën është e domosdoshme të dorëzohen edhe dokumentacioni dhe formularët AOJSH-1 dhe AOJSH-2.

### **Neni 28**

1) Lidhur me kërkesat e anëtarëve të Sindikatës vendos Komisioni për shpërndarje të mjeteve të Fondit solidar të cilin e zgjedh Kryesia.

2) Për rastet e jashtëzakonshme të cilat nuk janë të rregulluara me Rregulloren për Fondin solidar, Komisioni mund të vendos për kompensim me para për anëtarin më së shumti deri në shumën prej 6.000,00 denarë.

### **Neni 29**

1) Kryetari i sindikatës mund të sjell vendime për ndihmë me para për: të porsalindur, për fëmijë të regjistruar në klasë të parë të shkollës fillore, për vdekje të anëtarit të fondit dhe për dalje në pension.

2) Në raste të jashtëzakonshme, kryetari mund të sjell vendim edhe për shërim dhe për sigurim të barnave dhe pajisjeve ndihmëse mjekësore si dhe hua në para.

3) Për vendimet e mara mes dy mbledhjeve të Komisionit, në pajtim me paragrafët 1 dhe 2, Kryetari është i obliguar ta informoj Komisionin në mbledhjen e parë të radhës.

### **Neni 30**

1) Kundër vendimit të Komisionit për shpërndarjen e mjeteve nga Fondi solidar dhe vendimit të Kryetarit të Sindikatës, parashtruesi ka të drejtë ankese në Kryesinë e Sindikatës së AOJSH në afat brenda 15 ditëve.

2) Vendimi i Kryesisë së Sindikatës së AOJSH është përfundimtar.

3) Këqyrje në punën e Komisionit për shpërndarjen e mjeteve nga Fondi solidar kryen Kryesia e Sindikatës së AOJSH nëpërmjet të Këshillit mbikëqyrës.

### **Neni 31**

Vendimi i Komisioni lidhur me kërkesat e parashtruara, është e domosdoshme ti dorëzohet Kryetarit të Organizatës sindikale dhe parashtruesit. Mjetet e miratuara paguhen në llogarinë transkacionale të shfrytëzuesit ose nëpërmjet Organizatës sindikale ose Sindikatës së AOJSH.

## **VI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 32**

Punët administrativo-teknike për Fondin solidar i kryen shërbimi profesional i Sindikatës së AOJSH.

### **Neni 33**

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje kryhen në atë mënyrë dhe procedurë si edhe për sjelljen e së njëjtës.

### **Neni 34**

Me sjelljen e kësaj Rregulloreje ndërpritet vlefshmëria e Rregullores të sjell më datë 05.09.2012.

### **Neni 35**

Rregullorja hyn në fuqi në ditën në të cilën sillet.

**Sindikata e AOJSH të RM**  
Kryetar,  
Peco Grujovski

## **DOKUMENTET E NEVOJSHME**

Me kërkesën detyrimisht dorëzohen:

- \* Mendim (ekzemplari AOJSH 2);
- \* Kërkesë (për mjete të pakthyeshme - Ekzemplar AOJSH 1);
- \* Kërkesë (për hua me para - Ekzemplar AOJSH 3);

### **1. Ndhmë me para për pushim mjekësor me kohëzgjatje më të madhe**

- Ekzemplarë RPP – Raport për pengim të përkohshëm të punës në vazhdimësi jo më pak se 41 ditë, ose Mendim nga Komisioni për vazhdim të pushimit mjekësor.

### **2. Ndhmë me para për mjekim 2.1 Mjekim në Maqedoni**

- Mendim konsiliar, fletë lëshim, raport nga specialisti me konstatim histopatologjik;

#### **2.2 Mjekim jashtë vendit**

- Vendim nga FSSHM për mjekim jashtë vendit;
- llogari për shpenzimet e përgjithshme gjatë kohës së qëndrimit të cilat nuk janë mbuluar me aktvendimin e Fondit dhe të cilat do të mbështeten me llogari origjinale për shpenzimet e bëra për vendosje dhe/ose për ushqim.

### **3. Ndihmë me para për mjekim dhe pajisje ndihmëse mjekësore**

- mendim konsiliar,
- fletë lëshim,
- raport specialistik me konstatim histopatologjik;
- fatura/kupon fiskal nga vendi ose jashtë vendit.

### **4. Rrezikimi i gjendjes materiale**

- Vërtetim për rrogën e kërkuesit për muajin e fundit;
- Vërtetim nga Agjencia për punësim për anëtarët e familjes më të ngushtë se nuk janë të punësuar;
  - Certifikatë për gjendjen materiale nga Drejtoria për të ardhura publike për anëtarët më të ngushtë të familjes së tij;
  - Vërtetim për regjistrim të rregullt për vitin shkollor për anëtarët më të ngushtë të familjes – nxënës ose student;
  - certifikatë nga libri amë për të lindur për fëmijë më të vegjël se shtatë vite.

### **5. Ndihmë me para për fëmijën e porsalindur**

- Certifikatë nga libri amë për të lindur.

### **6. Ndihmë me para për nxënës të klasës së parë**

- Certifikatë nga libri amë për të lindur;
- Vërtetim nga shkolla për regjistrim në klasë të parë.

### **7. Ndihmë me para për pasoja më të rënda nga fatkeqësi natyrore**

- Vërtetim zyrtar nga organi kompetent për dëmin e pësuar;
- Provë për pronësi të banesës – flet pronësi.

### **8. Ndihmë me para në rast të vdekjes së anëtarit të Fondit**

- Certifikatë të fotokopjuar nga libri amë për të vdekurit;  
a) vdekje e anëtarit të familjes më të ngushtë të tijë;
- Certifikatë të fotokopjuar nga libri amë për të vdekurit;
- Letërnjoftimi i fotokopjuar;
- Certifikatë të fotokopjuar nga libri amë për të lindur të Kërkuesit, jo më të vjetër se gjashtë muaj (kur kërkuesi është anëtarë më i ngushtë i familjes).

### **9. Ndihmë me para për shkuarje në pension**

- Aktvendim për pensionim nga FONDI SPIM;
- Deklaratë për pensionim (e plotëson kryetari i organizatës sindikale);
- Me kërkesën të kthehet kartela e anëtarësimit.

### **10. Ndihmë me para gjatë grevës**

- Sipas Vendimit të Kryesisë për këtë lloj të ndihmës, kërkesë parashtrajnë organizatat sindikale.



## **11. Ndhimë me para në raste përjashtimi ose pasojave financiare të shkaktuara për shkak të aktiviteteve sindikale**

- Aktvendim për ndërprerje të marrëdhënies së punës ose Aktvendim për shqiptimin e masës disiplinore.

## **12. Hua me para**

### **12.1 Për mjekim**

- vërtetim nga institucioni në të cilin mjekohet dhe diagnoza e sëmundjes nga e cila mjekohet pacienti

### **12.2 Për shkollim**

- vërtetim për regjistrim në vitin vijues dhe shuma e pagesës për shkollim.

### **12.3 Për fatkeqësi natyrore**

- Vërtetim zyrtar nga organi kompetent për dëmin e pësuar;
- Provë për pronësi të banesës – flet pronësi.

- **12.4 Për çfarëdo raste tjera** të cilët nuk janë theksuar në Rregullore – dokumente me të cilat do të arsyetohet huaja e cila kërkohet.

